

VENDIM
Nr. 357, datë 1.12.2023

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pikat 4 dhe 5, dhe 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2195/6 prot., datë 22.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Energy Financing Team Tirana’ sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 127, datë 31.5.2022 dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 31.5.2022. Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2195 prot., datë 26.9.2023 dhe nr. 2196 prot., datë 26.9.2023, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 100 % të kuotave të zotëruara nga ortaku “EFT International Investments Holdings LTD” sh.p.k. tek “EFT Investments Limited”.

- Për të sqaruar dokumentacionin e konstatuar të munguar të këtij aplikimi, me shkresën nr. 2195/2 prot., datë 13.10.2023, ERE i njoftoi shoqërisë këtë dokumentacion dhe e ftoi në një seancë dëgjimore në datën 20.10.2023, e cila u zhvillua në datën 6.11.2023, pas kërkesës së paraqitur nga përfaqësuesit e shoqërisë, me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 2195/3 prot., datë 18.10.2023, për shtyrjen e datës së zhvillimit të kësaj seance.

- Pas sqarimeve të dhëna në seancë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2195/4 prot., datë 6.11.2023, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është depozituar dhe dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.

- Duke qenë se marrëveshja për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është nënshkruar përpara marrjes së autorizimit të ERE-s, nga ana e shoqërisë është depozituar dhe deklarata, ku, ndër të tjera, përcaktohet se marrëveshja nuk ka kurrësi për qëllim rënien ndesh me rregullat e lidhura me dy licencat e shoqërisë e, po ashtu se, shoqëria dhe grupi EFT angazhohen të nënshkruajnë, depozitojnë, regjistrojnë dhe kryejnë çdo veprim të nevojshëm për rikthimin e strukturës së ortakërisë në gjendjen para nënshkrimit të Marrëveshjes, në rast se kjo gjë do të jetë e nevojshme, si dhe për të respektuar të gjitha kushtet e licencave të lëshuara nga ERE.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., bëhet “EFT Investments Limited”.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti